



FAKULTETI JURIDIK I UNIVERSITETIT TE PRISHTINES

SHPALL:

KONKURS PER PRANIMIN E DY PRAKTIKANTËVE ME PAGESË PËR MIRËMBAJTJEN DHE PËRDITËSIMIN E PLATFORMES “GJYKATA IME” ([www.gjykataime.org/.](http://www.gjykataime.org/))

Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës ka nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit me Projektin e USAID/Fuqizimi i Sistemit të Drejtësisë (“Projekti JSSP”) për rritjen e transparencës së gjyqësorit në Kosovë, përmes platformës “Gjykata Ime” (www.gjykataime.org).

Në kuadër të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës shpallë thirrje për pranimin e dy studentëve të cilët do të jenë përgjegjës për mirëmbajtjen, përditësimin dhe fuqizimin e platformës “www.gjykataime.org” e cila është dizajnuar nga USAID/Projekti për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë, dhe do t’iu shërbejë qytetareve që të marrin informacione të nevojshme për gjykatën, procedurat gjyqësore, lëndët në gjykim dhe informatat tjera relevante për gjyqësorin.

Kriteret dhe Kualifikimet

- Të jetë student/e i/e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës (Bachelor ose Master);
- Të njohë rrjedhshëm gjuhen Angleze (në të folur dhe në të shkruar);
- Të posedojë shkathtësi bazike të përdorimit të kompjuterit duke përfshirë programet: Word, PowerPoint, Excel, dhe programet tjera softuerike;

Dokumentet e kërkuara për aplikim:

- CV e kandidatit/ës
- Transkripta e notave
- Letër Motivuese (max. 500 fjalë).

Detyrat dhe përgjegjësitë e praktikantëve:

- Të mirëmbajë dhe përditësojë informacionin që ofrohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe gjykatat në platformën ‘www.gjykataime.org’, duke siguruar që informacioni që është zyrtar dhe u përket gjykatave, është konfirmuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës para publikimit;
- Në baza gjashtë (6) mujore të përditësojë të dhënat në “Trend Analysis Dashboard” sipas të dhënave që i dërgon Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- Të identifikoj dhe përmirësojë gabime apo të plotësojë zbrazëtira në platformë sipas bashkëpunimit me palë të treta apo punës së brendshme të UP/Fakultetit Juridik;
- Detyra tjera për Fakultetin Juridik të cilat mund të përcaktohen nga Zyra e Dekanit, bazuar edhe në Marrëveshjen me kandidatin/en e suksesshëm.

Kohëzgjatja: Maksimum deri në një (1) vit.

Të gjitha aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në emailin: juridiku@uni-pr.edu deri me datën **10.12. 2021 ne ora 17:00**. Aplikacionet e pranuar pas këtij afati nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen.

Titulli i e-mailit duhet të jetë “**Aplikim për Punë Praktike_Gjykata Ime**”.

Projekti mbështetet nga USAID/Projekti për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë.